



In medias res

KUJDES NGA PËRDORIMI I KONCEPTIT REFORMË!!!?

Në përditshmërinë tonë kosovare, termat reformë, reforma të arsimit, reforma në arsim, reformat apo reforma në shëndetësi, administratë, reforma në UP etj., janë konsumuar aq shumë, sa sot ato, as nuk paraqesin lajm, e as nuk sjellin dobi dhe përmirësime pozitive. Ajo që është më fatale, ato nuk mund të nxjerrin Kosovën nga kriza e tashme e përgjithshme. Përdorimi pafundësisht i shpeshtë i këtij koncepti tek ata që merren me ndryshime pozitive, sjellë neveri.

Fjala reformë rrjedhe nga fjala latine “reforma” që do të thotë, ndryshim në formë, përmirësim, ndryshim pa përmirësuar esencën. Gjendja e vështirë e Kosovës në përgjithësi dhe në arsim në veçanti është e atillë sa ajo nuk mund përmirësohet me arnime, ndryshime dekorative dhe grimime, por me ndryshime shumë të sofistikuara dhe të thella me të cilat duhet të ndërrohet mendësia publike qytetare. Me to, duhet krijuar një vetëdije të re për rolin dhe rëndësinë që ka sistemi i edukimit për të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës. Për këtë arsye koncepti “reformë” duhet të zëvendësohet me konceptin transformim dhe transformime. Ky koncept nënkupton ndryshime edhe në formë edhe në struktura. Për të bërë ndryshimet edhe në formë edhe në strukturë ato duhet të jenë të thella sepse duhet të ndryshojë tërësia duke i ndryshuar pjesët e tërësisë, por duke i parë ato në lidhshmëri dhe kauzalitet multipleks.

Këto ndryshime strukturore të bazuara në standarde të avancuara dhe në pritshmëri të larta sjellin ndryshime cilësore që kanë impakt të fuqishëm në zhvillimin ekonomik, në zhvillimin e përgjegjësisë qytetare dhe të demokracisë liberale

Në Kosovë, nga viti 2000 e këndeje të gjitha nismat “reformuese” janë shndërruar në “reformatio in pejuis” në ndryshime retrograde që e kanë thelluar akoma më shumë krizën në arsim.

Në edukim përfshihen shume njerëz. Përfshirja e madhe e tyre bën që procesi i edukimit të jetë shumë kompleks dhe jo plotësisht i kuptueshëm dhe i qartë. Për këtë arsye ndryshimet në arsim janë shpesh jo të qarta dhe me vështirësi drejtohen, udhëhiqen dhe menaxhohen. Qëllimi i ndryshimeve në edukim është zhvillimi maksimal i mundshëm i të gjithë nxënësve dhe studentëve, përgatitja e tyre për t’u bërë qytetarë të përgjegjshëm që do të jenë të gatshëm të marrin pjesë aktive në tregun botëror të punës, pajisja e tyre me sistemin e vlerave të cilat njeriun bëjnë njeri, aftësimi i tyre që të mësojnë gjatë gjithë jetës si dhe që të jenë në gjendje që duke i përdorë dijet të krijojnë dhe prodhojnë dije të reja me të cilat sigurohet një përparim i vazhdueshëm si i individëve ashtu edhe i shoqërisë.

Nëse nismat reformuese të bëra deri më tani në Kosovë i vështrojnë nga ky kënd, atëherë del se këto qëllime nuk janë arritur dhe nuk po arrihen dot. Dëshmi për këtë janë: shkalla e lartë e analfabetizmit të tri niveleve; braktisja e sistemit të edukimit dhe të arsimit të detyruar; niveli i ulët i arritjeve të treguara në testet kombëtare, shkallë e ulët e përfshirjes së fëmijëve në të gjitha nivelet e arsimit krahasuar me standardet ndërkombëtare; delikuenca e të miturve në rritje, rritja e shkallës së sjelljeve asociale siç janë dhuna ndërmjet nxënësve, droga, etj. Këta tregues imponojnë nevojën që në Kosovë të flitet për transformime- ndryshime të thella pozitive dhe jo për reforma, dhe ndryshime kozmetike dhe improvizime.

Shkroi: Halim Hyseni

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSh

■ KEC në bashkëpunim me zyrën e OSCE në Mitrovicë në muajin shtator ka filluar trajnimin e 19 mësimitdhënësve të Sh. F. "Isa Boletini" të fshatit Boletin dhe Sh.F. "Kadri Bistrica" të fshatit Bistricë të komunës së Zveçanit. Gjatë këtij muaji janë realizuar tre seminare 2-ditore, monitorimi i të gjithë mësimitdhënësve pjesëmarrës në trajnim, si dhe një takim gjysmë-ditor në të cilin janë diskutuar orët e monitoruara. Nga raportet e trajnerëve kuptohet se programi është duke u zhvilluar shumë mirë dhe se mësimitdhënësit janë të kënaqur me programin e trajnimit dhe përgatitjen e trajnerëve.

■ Gjatë muajit shtator janë bërë përgatitjet për fillimin e 7 grupeve të trajnimit në kuadër të programit të MKLSh-së në 6 komunat kryesore të Kosovës: Prishtinë (2 grupe), Gjakovë, Pejë, Mitrovicë, Ferizaj dhe Gjilan. KEC ka bashkëpunuar me zyrën e trajnimeve në MASHT dhe përfaqësuesit e DKA-ve përkatëse për të bërë përzgjedhjen e kandidatëve për trajnim, të cilët do të fillojnë trajnimin me 4-5 tetor 2008. Në Prishtinë është vendosur të jenë 2 grupe për shkak të numrit të madh të mësimitdhënësve të interesuar, ndërsa në Prizren pritet që KEC në bashkëpunim me Bankën Botërore të fillojë trajnimin e 4 grupeve.

■ KEC ka përkrahur kërkesën e Qendrës Didaktike (QD) në Gjakovë për trajnimin e një grupi të mësimitdhënësve. Kjo kërkesë është rezultat i një hulumtimi të zhvilluar nga përfaqësuesit e QD në Gjakovë, në të cilën shihet një interesim i jashtëzakonshëm i mësimitdhënësve për t'u përfshirë në programin e trajnimit të

MKLSh-së. Ky grup seminarin e parë e ka mbajtur më 27-28 shtator 2008.

■ Më datën 27-28 shtator KEC ka organizuar një trajnim 2-ditor për Metodën e Kornizës Logjike (MKL) për 29 mësimitdhënës nga mbarë Kosova që kanë kryer trajnimin e MKLSh-së dhe kanë kërkuar që të trajnohen dhe për MKL. Nga fletëvlerësimet shihet se trajnimi është pritur jashtëzakonisht mirë dhe mësimitdhënësit kanë qenë të kënaqur me programin e trajnimit dhe përgatitjen e trajnerëve. Ky grup është certifikuar më 29 shtator 2008.

Hap pas Hapi

■ Në fshatin Plemetin të Komunës së Obiliqit, në datat 21, 22, 26, 27, 28 në bashkëpunim me Balkan Sunflowers (BSF) është organizuar trajnimi bazik për klasën e parë. Në trajnim morën pjesë fasilitatorët dhe tutorët të cilët punojnë me fëmijët e komunitetit rom. Qëllimi i trajnimit ishte që t'iu mundësoj atyre të aftësohen më mirë për punën të cilën ata kryejnë me fëmijët gjatë aktiviteteve jashtëshkollore, duke njohur më mirë fazat e zhvillimit të fëmijëve dhe duke përshtatur aktivitetet për mosha të caktuara

■ Me 20,21,27,28,29 në zyrat e KEC u organizua trajnimi bazik për klasën e parë. Pjesëmarrësit ishin të përzgjedhur nga konkursi i shpallur para disa kohe.

Projekti për krijimin e mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane shoqëri dhe shkolla

■ Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) ka filluar zbatimin projektit: Të krijojmë një mjedis të sigurt, jo të dhunshëm dhe

human në shoqëri dhe në shkolla. Projekti financohet nga UNICEF dhe ka për qëllim:

- ✚ Të kontribuojë në krijimin mjediseve miqësore për fëmijë dhe qytetare
- ✚ Të kontribuojë në krijimin e një shoqërie kohezive në të cilën të gjithë qytetarët dhe fëmijët e Kosovës do të punojnë, rriten dhe zhvillohen në mjedise të sigurta, të qeta, jo të dhunshme dhe humane
- ✚ Të kontribuojë që njeriu të vendoset të në qendër të vëmendjes dhe të përkujdesjes me dashuri pavarësisht nga prejardhjet e tyre etnike, racore, fetare, sociale gjinore etj
- ✚ Të kontribuojë që të krijohet një vetëdije e lartë për rolin dhe rëndësinë që kanë barazia dhe drejtësia qytetare në krijimin mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane

Për realizimin e këtij qëllimi janë paraparë këto objektiva:

- ✚ Hartimi i një programi koherente veprimi të institucioneve përkatëse për krijimin e mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane
- ✚ Vetëdijesimi i qytetarëve dhe nxënësve për rolin dhe rëndësinë që kanë mjediset e sigurta, jo të dhunshme dhe humane për zhvillimin shoqërisë kosovare
- ✚ Krijimi i rrjeteve të fuqishme të adresave dhe të strukturave për krijimin e mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane nga nivelet e institucioneve deri te niveli qendror

Deri më tani nga ky projekt janë realizuar këto aktivitete:

1. Është hartuar agjenda e trajnimit për trajnerë
2. Është hartuar projekti për zhvillimin e hulumtimit të shpejtë për: vlerësimin gjendjes së drejtave të fëmijës në arsimin e detyruar të Kosovës, për vlerësimin punës së Komiteteve shkollore për mbrojtjen e të

drejtave të fëmijës dhe të Këshilltarëve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës .

3. Është caktuar ekipi hulumtues,
4. Janë bërë përgatitjet për organizimin seminarit në Strugë i cili do të mbahet me 14-17 tetor 2008.

Projekti për përmirësimin e pjesëmarrjes në Arsim PPPA II

■ Në kuadër të komponentës së granteve shkollore nën Projektin për përmirësimin e pjesëmarrjes në arsim, ka filluar implementimi i projekteve të shkollave të ciklit të dytë. Kësaj i ka paraprirë një trajnim njëditor për prokurim dhe financa. Përmes këtij trajnimi, pjesëmarrësit e shkollave përfituese të granteve shkollore, janë pajisur me shkathtësi për udhëheqjen e procedurave të prokurimit dhe menaxhimit të financave për projektet e tyre shkollore.

Stafi i KEC i angazhuar në projekt është duke bërë monitorimin e implementimit të projekteve shkollore.

■ Në kuadër të komponentës së granteve komunale, komunitet përfituese kanë hartuar planet zhvillimore komunale në arsim dhe kanë përgatitur projekt-propozimet për financim. Këto plane dhe projekte janë dërguar te Ekipi koordinues i Projektit dhe pritet që së shpejti të vlerësohen nga Këshilli për Aproximin e Granteve (KAGSh)

Monitorimi i implementimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE në arsim

■ Në kuadër të projektit "Monitorimi i Implementimit të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve RAE në

Arsim”, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), më 2 shtator 2008, në Grand Hotel, bëri prezantimin publik të raportit të parë të monitorimit të implementimit të Strategjisë. Të pranishëm në këtë diskutim publik ishin përfaqësues të MASHT, KFOS, KEC, Organizatave të shoqërisë civile të komuniteteve RAE, përfaqësues të medias etj.

Pas përfundimit të prezantimit, u hap debati lidhur me raportin, me ç’rast, të pranishmit shprehën opinionet e tyre lidhur me raportin e monitorimit por edhe gjendjen sa i përket edukimit të komuniteteve RAE. Në përgjithësi raporti u vlerësua si i qëlluar, real dhe konciz, por nuk munguan as kritikrat, që kishin të bëjnë kryesisht me gjuhën e përdorur në raport.

Ndryshe, Raporti i Monitorimit është hartuar nga Ekipi për Monitorim, duke u bazuar në Kornizën e Monitorimit të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë - komponenta e edukimit 2007-2017. Raporti analizon të arriturat dhe mangësitë e bartësve të Strategjisë, para së gjithash, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës (MASHT) në implementimin e Strategjisë. Në raport paraqitet rezultati i punës së monitorimit të realizimit të atyre masave të Strategjisë që është paraparë të fillojnë së implementuari në vitin 2008. Monitorimi është bërë për periudhën janar-qershor 2008.

Debati i radhës dhe publikimi i raportit të dytë të monitorimit pritet të bëhet në muajin dhjetor.

■ Po ashtu, në kuadër të këtij projekti gjatë këtij muaji është zhvilluar edhe një aktivitet social në Gjakovë. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin fëmijë dhe të rinj nga komunitetet RAE të cilët atë ditë ndoqën një punëtori gjysmëditore për të drejtat e fëmijës. Pas trajnimit u organizua edhe një shëtitje në parkun e qytetit ku patën rastin edhe të luajnë dhe të shoqërohen më shumë mes veti.

Mentorimi i projekteve për përkrahje të arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

■ Në kuadër të këtij projekti, në fillim të shtatorit u organizua takimi i përbashkët i tre përfaqësuesve të qendrave respektivisht OJQ-ve të përfshira në këtë projekt. Në këtë takim pjesëmarrësit prezantuan punën e tyre dhe planet për katërmujorin e ardhshëm. Gjithashtu në këtë takim u diskutua për idenë e hartimit të një projekti të përbashkët të të tri qendrave.

■ Gjatë këtij muaji janë kryer disa vizita në terren. Qëllimi i vizitave ka qenë për t’i parë nga afër ecurinë e aktiviteteve të qendrave, dhe në përgjithësi punën e qendrave, dhe për t’iu ofruar ndonjë ndihmë apo konsulentë. Këto vizita janë zhvilluar edhe në mjediset tjera ku zhvillohen aktivitetet e projekteve. Gjatë vizitave ka pasur edhe shumë takime me përfituesit e projekteve.

KOSOVISION Contest

■ Pas dy takimeve të cilat u mbajtën me përfaqësues nga Zvicra, filloi edhe implementimi i projektit KOSOVISION CONTEST.

Projekti ka tri qëllime kryesore:

1. Ngritjen e vetëdijes tek fëmijët lidhur me problemet e tanishme në Kosovë;
2. Nxitje e fëmijëve të mendojnë për të ardhmen dhe fuqizimin e tyre në paraqitjen e përvojave dhe mendimeve me qëllim të zhvillimit të vizioneve të përbashkëta;
3. Gjetjen e zgjidhjeve dhe zbatimin e tyre në formë të projekteve;

■ Në kuadër të këtij projekti, gjatë këtij muaji janë zhvilluar disa aktivitete. Një numër prej 11 personave janë angazhuar si staf lokal i projektit, nga

rajonet e ndryshme të Kosovës të cilët do të ndihmojnë në realizimin e këtij projekti. Një punëtor dy ditore është mbajtur nga përfaqësues zviceran. Qëllimi i punëtorisë ishte që stafi lokal të kuptojë obligimet dhe detyrat që kanë në projekt.

Mbledhjet me Drejtorët e Drejtorive Komunale të Arsimit dhe me drejtorët e shkollave kanë filluar të mbahen nga stafi lokal. Qëllimi i këtyre takimeve është që drejtorët të njoftohen më shumë për projektin, dhe që informacionet e mara nga stafi, të shpërndahen tek mësuesit të cilët do të punojnë në këtë projekt. Deri tani janë mbajtur mbledhje në 16 Komuna të ndryshme.

AVSI-CESAL, Cilësia e arsimit në regjionin e Dukagjinit

- Qendra për Arsim e Kosovës ka filluar edhe përgatitjen e pyetësorëve të cilat do të shpërndahen mësimdhënësve dhe drejtorëve të Rajonit të Gjakovës dhe Pejës. Pyetësorët do të iu ipen shkollave gjatë muajit shtator, ndërsa mbledhja dhe përpunimi i tyre do të bëhet gjatë muajve tetor dhe nëntor.

Përgatiti: Petrit Tahiri